



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

MINISTRI

Nr. Prot. 777/1

Df. 13.02.2020

URDHËR

Nr. 71, datë 13.02.2020

PËR

**RREGULLAT E HOLLËSISHME LIDHUR ME PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES
SË KOORDINATORËVE TË RRJETIT TË BIZNESIT, TË TRAJTIMIT TË
ANKESAVE DHE KËRKESAVE TË BIZNESIT, TË PËRCAKTIMIT TË DETYRAVE
DHE AFATEVE**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të Vendimit nr. 638, datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje" të ndryshuar, si dhe në zbatim të urdhrit nr. 7, datë 20.01.2020 "Për ngritjen dhe funksionimin e rrjetit të koordinatorëve të biznesit", të Kryeministrit,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e rrjetit të koordinatorëve të biznesit, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe institucionet e saj të varësisë, nën koordinimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.
2. Koordinatorët e biznesit caktohen ndër funksionarët e institucionit dhe kanë integritet dhe reputacion të lartë profesional.
3. Rrjeti i koordinatorëve të biznesit për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucionet e saj të varësisë do të ketë në përbërje:
 - a) Znj. Elfrida Brati përfaqësuese për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - b) Znj. Mandeta Minxhozi përfaqësuese për Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore;
 - c) Znj. Era Kollçaku përfaqësuese për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;
 - d) Znj. Petrina Ago përfaqësuese për Autoritetin Rrugor Shqiptar;
 - e) Znj. Menada Ujka përfaqësuese për Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial;
 - f) Znj. Zhaneta Canaj përfaqësuese për Postën Shqiptare;
 - g) Z. Kristi Jorgji përfaqësues për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve dhe Transportit Rrugor

3. Me qëllim realizimin e objektivit të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, rrjeti i koordinatorëve ka për detyrë të referojë dhe trajtojë ankesat, kërkesat, nismat, sugjerimet,

iniciativat, denoncimet për zgjedhje abuzive apo korruptive të ardhura nga sipërmarrjet private, të cilat adresohen në platformën elektronike "Me ty, për Shqipërinë që duam", në bashkërendim me institucionet e varësisë.

4. Koordinatori i rrjetit të biznesit i përgjigjet ministrit dhe titullarit të institucionit të varësisë.

5. Koordinatori i biznesit kryen detyrat funksionale si më poshtë vijon:

- a) Mban një *database* të rregullt, për të gjitha kërkesat/ankesat e ardhura në institucion, duke i ndjekur ato deri në kthimin e përgjigjeve pranë biznesit;
- b) Përpilon raporte dhe memo informuese kurdo kërkohet nga koordinatori i biznesit në Kryeministri dhe ministri;
- c) Përgatit dhe dërgon çdo të premte tek Ministri, një raport javor, duke përfshirë dhe raportin e institucioneve të varësisë. Raporti hartohet nën mbikëqyrjen e koordinatorit të biznesit në Kryeministri.
- d) Bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë urdhër, në bashkëpunim me kabinetin e ministrit, si dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë;
- e) Mban kontakte të vazhdueshme me njësitë e tjera organizative si, kabinetin e ministrit, sekretari i përgjithshëm, titullarët e institucioneve të varësisë të ministrive për zbatimin e detyrave.

6. Koordinatori pranë ministrisë dhe institucionit të varësisë i përgjigjet direkt koordinatorit të biznesit në Kryeministri, duke informuar në çdo kohë eprorët e tij lidhur me aktivitetin ditor, rezultatet e punëve në vazhdimësi, si dhe mbi vështirësitë e hasura në to.

7. Procedura e trajtimit të ankesave/kërkesave do të bëhet si më poshtë vijon:

- a) Ankesat e biznesit mund të paraqiten në këto mënyra:
 - i. Ankesa të paraqitura nëpërmjet portalit <https://www.shqiperiaqeduam.al/>
 - ii. Ankesa të paraqitura me shkrim nëpërmjet protokollit të ministrisë apo institucioneve të varësisë të përcaktuar, në pikën 3, të këtij urdhri.
- b) Në rastin e ankesave të paraqitura me shkrim nëpërmjet protokollit, veprohet si më poshtë:
 - i. Kur ankesa është paraqitur pranë protokollit në ministri, praktika protokollohet nga njësia e arkiv protokollit dhe ndërkohë që delegohet, një kopje e skanuar i dërgohet Koordinatorit në ministri për të vijuar me rregjistrimin e saj në sistem;
 - ii. Kur ankesa është paraqitur pranë protokollit të institucioneve të varësisë të përcaktuara në pikën 3 të këtij urdhri, praktika protokollohet nga njësia e arkiv protokollit, skanohet dhe i dërgohet me postë elektronike Koordinatorit të institucionit dhe ky i fundit përmes platformës ia dërgon koordinatorit në ministri.

- c) Me marrjen e ankesës, brenda 1 dite pune nga data e marrjes, koordinatori në ministri, në varësi të strukturës përkatëse me të cilën lidhet ankesa, ia përcjell atë nëpërmjet postës elektronike:
- i. Drejtorit të Përgjithshëm në ministri, i cili e shqyrton dhe trajton atë, brenda 6 ditëve pune dhe ia dërgon me postë elektronike Koordinatorit në ministri;
 - ii. Koordinatorit të institucioneve të varësisë të përcaktuar në pikën 3 të këtij urdhri, i cili brenda 1 dite pune nga data e marrjes, ia përcjell atë nëpërmjet postës elektronike, strukturës përkatëse me të cilën lidhet ankesa. Kjo e fundit, brenda 6 dite pune, shqyrton dhe trajton ankesën dhe ia dërgon atë koordinatori në ministri me postë elektronike, nëpërmjet koordinatori të institucionit të varësisë.
- d) Në rastet kur kërkesa/ankesa ka mungesë në dokumentacion, koordinatori njofton biznesin për këto mangësi dhe afati shtyhet me 10 ditë të tjera pune, nga momenti i njoftimit.
- e) Të gjitha ankesat e regjistruara në platformë kanë një afat procesimi prej 10 ditë pune.

8. Ngarkohen koordinorët e biznesit, si dhe nëpunësit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjië dhe institucioneve të saj të varësisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
REPLAZI I KËNDËSHIT
Belinda Balluku
MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
TIRANË

